



Për të parën herë në historinë e futbollit të klubit Luftëtari, prek vëndin e fundit e rënditjes në kampionatin e kategorisë së parë. Një humbje me rezultat të pastër në Pukë ndaj Velecikut, e ka detyruar skuadrën e Luftëtarit të zbresë në vëndin e fundit të rënditjes. Situata ku është mbërthyer futboli gjirokastrit është mjaft e rëndë , ndaj nuk mjafton vetem zhvillimi i një analize, por një projekt shpetimi nga drejtuesit e pushtetit vendor në atë qytet. Në ndeshjet e kësaj jave, vëmendja ishte përqëndruar te ndeshja e zhvilluar në qytetin e Pogradecit, ku vëndasit humbasin ndaj skuadrës së Apolonisë së vëndit të dytë. Goli i shënuar nga Papa në në të 10' , jo vetëm që jep një tre pikësh të rëndësishëm por dhe më shumë siguri në ndeshjet në vazhdim, duke ndjekur hap pas hapi, riavlen e vjeter, Elbasani qe ndodhet në vëndin e parë me dy pikë më shumë 26 pikë . Sipas burimeve nga qyteti i Pogradecit mësojmë se drejtuesit e skuadrës liqnore kanë kontestuar gjykimin e kryesorit B. Breshanjat nga Tirana, qe sipas vendasve gjyqtari kanë qenë tërësisht i një anëshëm. Një fitore me shumë vlerë ka marrë dhe skuadra e Elbasanit. Portokallinjët kanë mundur të fitojnë në fushën e vështirë të Himarës. Dygoleshi e E. Dalipit në 10' dhe 88' , ka zhvleftësuar golin e shënuar një minutë më vonë nga Dërvishi. Tërbuni ka fituar në transfertë, fitorja e pukjanëve ka ardhur ndaj Albetrol të Patosit e cila sic duket e ka të vështirë të ambjentohet në kategorinë e parë. Pukjanët janë të pozicionuar në vëndin e pestë në rënditje me 15 pikë dy më pajk se Tomori, që fitoi me një gol të shënuar ndaj Adës së Velipojës. Goli i shënuar në minutat e fundit të ndeshjes e mban skuadrën beratase nën presion e atyre skuadrave që synojne rikthimin në kampionatin e më të mirëve. Një ndeshje mjaft e fortë është zhvilluar në qytetin e Sarandës, ku Butrnti vëndas i drejtuar nga gjirokastriti i njohur Mustafa Hysi, ka mundur një skuadër me emër në futbollin shqiptar, Shkumbinin e Peqinit. Dy golat e shënuar kanë ardhur në pjesën e dytë. Një fitore e tyre konfirmon dhe nje herë që skuadra sarandiotë në fushën e saj është një kockë e fortë për cdo kundërshtar. Ndërkohë fitoret e Dinamos dhe Mamurrasit priteshin. Dinamo e vëndit të shtatë ende nuk po bind në lojën e saj e cila ende është larg pretendimeve për tu rikthyer në kampionatin e më të mirëve. Lufta e fortë sportive është përqëndruar për t'ju shpëtuar vëndeve të fundit. Mamurrasi i pozicionuar në vëndin e parafundit ka mundur në fushën asnjane të Shijakut, me rezultat të pastër Kamzën që dhe ajo po noton në ujra të turbullta. Ndeshjet e kampionatit të kategorisë së parë do të vijojnë javën e ardhëshme, ku më tepër spikat ndeshjet e Burrelit me Tomorin dhe ajo që do të zhvillohet në Gjirokastër mes Luftëtarit dhe Adës..

Kategoria 1/ Luftëtari prek fundin e tabelës

nga AlbaniaSoccer
E diel, 10 Nëntor 2013 01:00

Të shtunën, 9 nëntor 2013:

Dinamo - Burreli 1-0

Shënues: Djarmati 50'

Stadiumi "Selman Stërmasi", Tiranë

Tomori - Ada Velipojë 1-0

Shënues: Azizaj 86'

Stadiumi "Jani Kosta", Berat

Butrinti Sarandë - Shkumbini 2-0

Shënues: Kola 58' Dalipaj 78'

Kategoria 1/ Luftëtari prek fundin e tabelës

nga AlbaniaSoccer
E diel, 10 Nentor 2013 01:00

Stadiumi "Andon Lapa", Sarandë

Veleçiku Koplík - Luftëtari 2-0

Shënues: Nikshiq , 90'

Stadiumi "Ismail Xhemali", Pukë

Albpetrol Patos - Tërbuni Pukë 0-1

Shënues: Agastra 66'(11-m.)

Stadiumi "Alush Noga", Patos

Himara - Elbasani 1-2

Shënues: Dervishi 89', / E. Dalipi 10', 88'

Kategoria 1/ Luftëtari prek fundin e tabelës

nga AlbaniaSoccer
E diel, 10 Nentor 2013 01:00

Stadiumi "Petro Ruci", Himarë

Mamurrasi - Kamza 2-0

Shënues: Pengili 6', Malaj 47' / (Sulaj humbet 11-m. 88')

Stadiumi "Tofik Jashari", Shijak

Pogradeci - Apolonia 0-1

Shënues: Papa 10'

Stadiumi "Gjorgji Kyçyku", Pogradec